



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

01 -12- 2023

Ref. 2312/1235/KPM/jr

Radio Vizioni  
Fazli Veliu  
Drejtor  
Podujevë

VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2023/165 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për Radio Vizioni  
(Pala Përgjegjëse)**

Faktet

1. Pala përgjegjëse me datën 12 mars 2010, është pajisur me licencë të KPM-së me seli në Podujevë. Me marrjen e Licencës Pala përgjegjëse është obliguar që të respektojë Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës si dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM.
2. KPM me datën 17 dhjetor 2021 ka nxjerrë Rregulloren KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale. Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret, të drejtat dhe obligimet për ofruesit e shërbimeve mediale, pa marrë parasysh mënyrën e transmetimit në Republikën e Kosovës, me qëllim të garantimit të mbrojtjes së pluralizmit medial dhe interesit publik, si dhe të mundësohet garë e drejt dhe e barabartë në tregun medial në Republikën e Kosovës.
3. Me datë 12 mars 2017, KPM mori Vendim për ripërtëritjen e licencës së Palës përgjegjëse edhe për një afat prej 7 viteve për të ushtruar veprimtari në ofrimin e shërbimeve mediale audio, ashtu siç përcaktohet me nenin 21 paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në.
4. KPM, me datë 23 tetor 2023, ka pritur në takim me Palën përgjegjëse përmes të cilit është njoftuar se Pala përgjegjëse ka bërë ndryshim në pronësi rreth një muaj më parë, për shkaqe personale dhe shëndetësore. Gjithashtu, KPM ka verifikuar këtë në ueb faqen e Agjencisë për regjistrimin e bizneseve në Kosovë (ARBK) dhe është konstatuar se biznesi me emrin tregtar “Radio Vizioni” në të cilin është lëshuar licenca e Palës përgjegjëse e ka statusin e biznesit të shuar, çka nënkupton se pronësia është kaluar në një biznes tjetër se ndryshimet në pronësi pa miratim me shkrim nga KPM-ja, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, dhe se për ndryshime të tilla nevojitet miratim paraprak me shkrim nga KPM.
5. KPM bazuar në Raportin e departamentit të Licencimit të datës 2 nëntor 2023 ka gjetur se Pala përgjegjëse ka bërë ndryshim të pronësisë në certifikatën e regjistrimit të biznesit pa

miratim paraprak të KPM-së, duke vepruar kështu ne kundërshtim me Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës dhe Rregulloren KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

### Analiza ligjore

6. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Ligjin e KPM-së, Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, dhe Rregullores KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

7. Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 21 paragrafi 3, i Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se:

*“Licencat nuk mund të shfrytëzohen dhe barten pa autorizimin dhe pa aprovimin paraprak me shkrim të KPM-së.”.*

8. Në kundërshtim me nenin 18, të Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM – 2021/01, i cili përcakton se:

*“ Licencat nuk mund të shfrytëzohen dhe transferohen pa autorizim dhe pa aprovim paraprak me shkrim nga KPM”.*

9. Në kundërshtim me nenin 15, paragrafin 2, paragrafin 2.1, paragrafin 2.2 dhe paragrafin 3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, i cili përcakton se:

*2. “I licencuari nuk mund të bartë licencën ose frekuenc-ën(at) pa miratimin paraprak me shkrim të KPM-së.”*

*2.1. “Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së.”*

*2.2.” Kjo kërkesë do të zbatohet gjithashtu në rastin e ndryshimit të udhëheqësisë së të licencuarit, që është regjistruar si OJQ, në përputhje me Rregulloren e KPM-së për Kriteret Kualifikuese për Marrjen e Licencës. Në rastin kur KPM lejon transferimin e Licencës, në asnjë rrethanë nuk do të paguhet e as të pranohet asnjë kompensim financiar për transferimin e kësaj licence.”*

*3. “Kontrolli Efektiv i Frekuencës: I Licencuari nuk do të transferojë kontrollin efektiv të një frekuence të licencuar tek një palë e tretë, plotësisht ose pjesërisht, pa autorizim paraprak me shkrim nga ana e KPM-së.”*

10. KPM, bazuar Raportin e departamentit të Licencimit ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka bërë ndryshim të pronësisë në certifikatën e regjistrimit të biznesit pa miratim paraprak me shkrim nga KPM-ja.
11. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 21 paragrafin 3, të Ligjin e KPM-së, nenit 18, të Rregullores për Ofruesit e shërbimeve Mediale Audio dhe Aidiovizuele-KPM-2021/01, dhe nenit 15, paragrafin 2, paragrafin 2.1, paragrafin 2.2, dhe paragrafin 3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

### Vendim

12. Pala përgjegjëse sanksionohet me **Gjobë** në shumën prej njëmijë (1.000) euro në pajtim me 30 paragrafi 1.3 të Ligjit të KPM-së, për shkeljet të vazhdueshme të nenit 21, paragrafin 3, të Ligjin të KPM-së, nenin 18 Rregullores për Ofruesit e shërbimeve Mediale Audio dhe Aidiovizuele-KPM-2021/01, nenit 15, paragrafin 2, paragrafin 2.1, paragrafin 2.2, dhe paragrafin 3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
13. Pala përgjegjëse, obligohet që në afat prej tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij Vendimi ta plotësoj kërkesën me dokumentet për ndryshim në pronësi, ashtu siç është e përcaktuar me nenin 21, paragrafin 3 të Ligjin të KPM-së, nenin 18, Rregullores për Ofruesit e shërbimeve Mediale Audio dhe Aidiovizuele-KPM-2021/01, dhe nenit 15, paragrafin 2, paragrafin 2.1, paragrafin 2.2, dhe paragrafin 3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

### E drejta për ankesë

14. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
15. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Jeton MEHMETI  
Kryetar



24.11.2023

Datë